



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo
Komuna e Prishtinës



Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 17, pika **b** të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 11, paragrafi 1, pika 1.15, nenit 17, paragrafi 5 dhe neneve 20 dhe 26 të Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, nenit 7, paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ, nr. 05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe Parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit administrativ, nr. 04/2018, për transparencë në komuna dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2019, merr këtë

V E N D I M
PËR LËNIE NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKTDOKUMENTIT TË PLANIT
RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN TE FAKULTETI TEKNIK, NË
LAGJEN "BREGU I DIELLIT"

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

- 1.1. **MIRATOHET** Vendimi për lënie në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën te Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit".
- 1.2. Projektdokumenti nga pika 1 e këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Konsultimet publike

- 2.1. Projektdokumenti i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e parë vijuese pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- 2.2. Organizimin e diskutimit publik të projektdokumentit do ta bëjë Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.
- 2.3. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projektdokumenti, së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik – raportin, do t'i dorëzohen Kuvendit të Komunës së Prishtinës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Neni 3
Subjekti përgjegjës

- 4.1. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimi Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- 4.2. Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij projektdokumenti nga përgjegjësitë e tyre të parapara.

Neni 4
Kufiri i territorit

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm, gjendet në lagjen “Bregu i Diellit”, dhe përfshinë një sipërfaqe prej $S = 9.08$ Ha. Rugët që e kufizojnë këtë plan janë: rr. “Fadil Vata”, në pjesën veriore, rr. “Arbënor e Astrit Dehari”, në pjesën jugore, rr. “Xhevë Lladrovci”, në perëndim dhe rr. “Nezir Gashi”, në lindje. Parcelat ku shtrihet ky plan kanë pronësi komunale, shoqërore dhe një pjesë e parcelës private.

Parcelat 2735-1, 2734-0, 2726-0, 2725-0, 2724-0, 2723-0, 2722-0, 2720-0 dhe 2730-0 (pjesërisht), gjenden në Zonën kadastrale Prishtinë.

Parcelat ku shtrihet ky plan kanë pronësi private dhe komunale, dhe gjenden në ZK Prishtinë.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-315010/19, më 30.12.2019

KRYESUES I KUVENDIT
Agim Kuleta

